



V E N D I M
K.P.P. 105/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.03.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozime”, me objekt, “Blerje rakorderi HDPE 10 ATM të ndryshme për nevojat e Shoqërisë për vitin kalendarik 2018”, me nr. REF-46771-02-12-2018, me fond limit 2,772,900 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Lushnje sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “ALEN-CO” sh.p.k.
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, P. “Delta 1”, 1001, Tiranë

Autoriteti kontraktor: Ujësjiellës Kanalizime Lushnje sh.a.
Adresa : Lagjia “ 18-Tetori”, Lushnje.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:


I

Vlerësimi paraprak

I.1.Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2.Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Autoritetit Kontraktor.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.02.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozime*”, me objekt, “*Blerje rakorderi HDPE 10 ATM të ndryshme për nevojat e Shoqërisë për vitin kalendarik 2018*”, me nr. REF-46771-02-12-2018, me fond limit 2,772,900 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Lushnje sh.a.

II.2. Në datën 20.02.2018 operatori ekonomik ankimues “ALEN-CO” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ALEN-CO” sh.p.k., KPP vëren se: Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se në datën 20.02.2018, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kërkon modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, ankim i cili referuar

referuar dëftesës të pranimi të objekteve postare, të Posta Shqiptare sh.a, nr.RR262364859AA është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datën 20.02.2018.

II.4.Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues si edhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.482/1 protokoli datë 21.02.2018, trajtim i ankesës së autoritetit kontraktor, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë këtij të fundit, nuk ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.5.Në datën 28.02.2018, operatori ekonomik “ALEN-CO” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj

Arsyeton

III.1. Në datën 13.02.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozime*”, me objekt, “*Blerje rakorderi HDPE 10 ATM të ndryshme për nevojat e Shoqërisë për vitin kalendarik 2018*”, me nr. REF-46771-02-12-2018, me fond limit 2,772,900 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Lushnje sh.a.

III.2. Në datën 20.02.2018 operatori ekonomik ankimues “ALEN-CO” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.3. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ALEN-CO” sh.p.k., KPP vëren se: Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se në datën 20.02.2018, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kërkon modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, ankim i cili referuar referuar dëftesës të pranimi të objekteve postare, të Posta Shqiptare sh.a, nr.RR262364859AA është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datën 20.02.2018.

III.4.Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues si edhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.482/1 protokoli datë 21.02.2018, trajtim i ankesës së autoritetit kontraktor, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë këtij të fundit, nuk ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III.5.Në datën 28.02.2018, operatori ekonomik “ALEN-CO” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.6. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 1.1 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku parashikohet shprehimisht se: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.6.1.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues “ALEN-CO” sh.p.k., është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datë 20.02.2018, referuar dëftesës të pranimit të objekteve postare, të Posta Shqiptare sh.a, nr.RR262364859AA, administruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga ana e operatorit ekonomik ankimues, me anë të ankesës të paraqitur pranë KPP protokolluar datë 28.02.2018. Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar”, parashikohet se ankimi administrativ pranë Autoritetit Kontraktor dorëzohet me shkrim brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë

Autoritetit Kontraktor nis ditën e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në rastin konkret, Komsioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk e ka ezuaruar ankimin administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 1.1 të L.P.P.-së, pasi ankimi i dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatorit ekonomik ankimues më datë 20.02.2018 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor nis nga dita e publikimit të njoftimit të kontratës, dhe përfundon ditën e shtatë. Në rastin konkret, afati maksimal i paraqitjes së ankimit pranë autoritetit kontraktor nga ana e operatorit ekonomik ankimues është datë 19.02.2018. Për këtë arsye, ankesa e paraqitur prej këtij të fundit një ditë më vonë, është pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 1.1 të L.P.P.-së, duke mos u legjitimuar *ratione temporis* në dorëzimin e ankesës pranë autoritetit kontraktor.

III.6.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “ALEN-CO” sh.p.k., nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.6.3. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “ALEN-CO” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozime*”, me objekt, “*Blerje rakorderi HDPE 10 ATM të ndryshme për nevojat e Shoqërisë për vitin kalendarik 2018*”, me nr. REF-46771-02-12-2018, me fond limit 2,772,900 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Lushnje sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 378 Protokoli, Datë 28.02.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

